



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Teuta Krasniqi	24.06.2026	06.07.2026	2026/0399

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.06.2026, OE “Smart X Industries SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0399, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME RROBA CIVILE PËR ZYRTARET POLICOR” me nr. të prokurimit: "214/30400-26-2381-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 1,008.750.00€.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2026/0399 i dt:19.06.2026.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 27 i LPP-së Neni 69 i LPP-së Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik Neni 24 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Të nderuar, Me dt. 30.04.2026 është publikuar tenderi me “FURNIZIM ME RROBA CIVILE

PËR ZYRTARET POLICOR”. Pas analizës që i kemi bërë dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike për këtë aktivitet të prokurimit, ne kemi ardhur në përfundim që dosja dhe specifikat teknike nuk janë hartuar në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së, pasi që janë vendosur specifika diskriminuese dhe të paqarta, andaj pretendimet tona ankimore janë si në vijim: Fillimisht po e sqarojmë se nga analiza që kemi bërë në prokurim kemi vërejtur që AK-ja ka publikuar një vendim mbi refuzim të kërkesës për rishqyrtim të një operatori ekonomik. Nga analiza që i kemi bërë vendimit të AK-së, e kemi vërejtur që autoriteti kontraktues e ka lejuar që të ofertohej edhe me material, poliester në vend të materialit poliamid. Autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar në kundërshtim.

Ne nenin 24 paragrafi 7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, ku specifikohet qartë “Nëse para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, bëhet e nevojshme nga AK që të ndryshohet ose përmirësohet Dosja e Tenderit, Lista e çmimeve, të dhënat në njoftim për kontratë, të bëhet zgjatja e afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, atëherë ndryshimet ose përmirësimet nga AK bëhen vetëm duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54”. Autoriteti Kontraktues pasi që ka lejuar të ofertohej edhe me material poliester, por duke mos i njoftuar të gjithë OE përmes formularit standard për korrigjim të gabimeve ka krijuar paqartësi dhe trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë. Operatori ekonomik që ka pranuar përgjigjen është njoftuar se lejohet edhe materiali poliester, ndërsa operatorët e tjerë kanë mbetur të orientuar nga kërkesa e Dosjes së Tenderit që parasheh materialin poliamid. Po të mos e kishim analizuar vendimin e AK-së, nuk do të kishim qenë në dijeni për këtë ndryshim. Prandaj, një ndryshim i tillë është dashur të publikohet zyrtarisht përmes formularit B54 dhe ndryshimit të Dosjes së Tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të informoheshin në mënyrë të barabartë. Andaj kërkojmë që të bëhet një ndryshim i tillë edhe në dosjen e tenderit, me qëllim që të gjithë OE të jenë të njoftuar për ndryshime të tilla. Në vendimin e lartcekur, ne e kemi vërejtur që AK-ja e ka shënuar “OE gjatë ofrimit të mostrave duhet të sjell edhe katalogun me kode të ngjyrave”. Edhe në këtë rast AK-ja ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur, pasi që OE të cilët nuk e kanë analizuar përgjigjen që AK-ja i ka dhënë OE që ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në momentin e ofertimit do të eliminoreshin në rast se nuk do të prezantonin katalogun me kode të ngjyrave. Ne si kompani konsiderojmë se një sqarim i tillë është i panevojshëm, pasi kjo kërkesë tashmë është e përcaktuar në specifikat teknike, ku kërkohet që të ofrohet katalogu për artikujt dhe në katalog të jenë të specifikuara të gjitha llojet e ngjyrave sipas kodeve përkatëse. Për rrjedhojë, konsiderojmë se kërkesa e paraparë në Dosjen e Tenderit është e mjaftueshme dhe nuk ka nevojë për kërkesa apo interpretime shtesë që mund të krijojnë paqartësi gjatë zbatimit të procedurës. Në dosje të tenderit tek specifikimet teknike për artikujt: **RROBAT ELEGANTE [KAT] PËR ZYRTARET POLICOR** dhe **SETËR PËR ZYRTARET/HETUESIT POLICOR**, toleranca e materialit është specifikuar +/- 3%, ndërsa tek produktet tjera toleranca është specifikuar +/- 5%. Ne kërkojmë që të lejohet toleranca prej +/- 5% për të gjitha artikujt e kërkuar, pasi që është e paqartë dhe e pakuptueshme se përse tek pantollonat lejohet toleranca prej +/- 5%, ndërsa për setrën dhe katin e rrobave lejohet vetëm +/- 3% toleranca. Gjithashtu, pasi që të lejohet toleranca prej +/- 5% edhe për setrën dhe katin për zyrtarët policor, ne kërkojmë që të specifikohet saktë përbërja e materialeve përmes intervaleve minimale dhe maksimale të lejueshme për secilin komponent të materialit. Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë mënyrën e aplikimit dhe llogaritjes së tolerancave të përcaktuara për përbërjen e materialeve. Për shembull, për kërkesën “70% lesh, 26% poliamid/poliester, 4% elastan me tolerancë +/- 5%”, a do të konsiderohet e pranueshme përbërja 65%-75% lesh, 21%-31% poliamid/poliester dhe 1%-9% elastan, apo toleranca do të llogaritet në ndonjë mënyrë tjetër? Specifikimi aktual nuk e tregon qartë metodën

e llogaritjes së tolerancës, gjë që mund të çojë në interpretime të ndryshme nga operatorët ekonomikë dhe gjatë vlerësimit të mostrave.

Prandaj, kërkojmë që AK-ja të sqarojë qartë këtë kërkesë dhe të lejoj tolerancën prej $\pm 5\%$ për katin dhe setrën. Njëkohësisht kërkojmë që të përcaktohet edhe pesha e materialit, ku pesha ideale për produktin RROBAT ELEGANTE [KAT] PËR ZYRTARET POLICOR është 235–265 g/m². Tek vendimi i kërkesës për rishqyrtim i publikuar në prokurim nga autoriteti kontraktues e kemi vërejtur që OE që ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në lidhje me specifikimet teknike ku është kërkuar: Pantallonat për zyrtarët/hetuesit policorë të kenë përbërje: 86% lesh (wool), 10% poliamid, 4% elastan ($\pm 5\%$); Ndërsa për produktin tjetër është kërkuar: Setra për zyrtarët/hetuesit policorë të ketë përbërje: 70% lesh (wool), 26% poliamid, 4% elastan ($\pm 3\%$); AK-ja është arsytuar se arsyeja se përse ndryshon materiali i pantallonave dhe setrës është sepse këto kombinohen mes vete dhe nuk janë si set i veshjes dhe duhet të përshtaten për nevoja policore. Sipas të lartcekurave edhe ne si OE mendojmë që përbërja e materialit të pantallonave dhe setrës duhet të jetë e njëjtë, mirëpo duhet të ndryshoj vetëm pesha e materialit. Kur kemi parasysh kushtet klimatike të Republikës së Kosovës dhe faktin që zyrtarët policorë i përdorin këto veshje për periudha të gjata gjatë ditës, ne nuk rekomandojmë përdorimin e përbërjeve me përqindje të lartë leshi për përdorim të përditshëm. Materialet me bazë leshi janë më të përshtatshme për përdorim ceremonial ose formal dhe zakonisht nuk ofrojnë komoditet optimal gjatë përdorimit të vazhdueshëm për më shumë se 4–5 orë. Për këtë arsye rekomandojmë që për xhaketat dhe pantallonat e përditshme të lejohet përbërja: • 60-70% poliestër; • 25- 35% viskozë; • 1-10% elastan; Ndërsa për peshën rekomandojmë që të specifikohet si në vijim: Për pantallonat: 270–285 g/m², ndërsa për setrën: 310–330 g/m². Rekomandimi ynë siguron komoditet të lartë gjatë përdorimit të zgjatur, ajrosje më të mirë të materialit, qëndrueshmëri të shtuar ndaj konsumimit, si dhe një pamje elegante dhe profesionale. Gjithashtu, kontribuon në mirëmbajtje më të lehtë të veshjeve, duke e bërë më praktike për përdorim të përditshëm në kushte të ndryshme operative. Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, kërkojmë që përbërja e materialit të pantallonave të jetë e njëjtë me përbërjen e materialit të setrës, ndërsa dallimi i vetëm ndërmjet tyre të jetë pesha e materialit. Kjo do të siguronte një qasje më të unifikuar në specifikimet teknike dhe do të mundësonte pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Njëkohësisht për pantallonat kërkojmë që të specifikohet kërkesa që pantallonat të prodhohen pa përfundim final në pjesën e poshtme, për shkak se kjo do t’u mundësonte përdoruesve përshtatje individuale sipas gjatësisë së kërkuar. Tek produkti KËMISHA PËR ZYRTARET/HETUESIT POLICOR, është shënuar përbërja: 75% pambuk-cotton, 25% poliestër toleranca $\pm 5\%$. Ne kërkojmë që përbërja e këmishës të ndryshohet në 55-65% pambuk dhe 35-45% poliestër, pasi kjo përbërje siguron nivel më të lartë të komoditetit, frymëmarrjes së materialit dhe absorbimit të lagështisë krahasuar me përbërjen 75% pambuk dhe 25% poliestër. Ndërkohë, përmbajtja prej 35-45% poliestër vazhdon të garantojë qëndrueshmërinë, rezistencën ndaj konsumimit dhe stabilitetin dimensional të këmishës.

Për këtë arsye, përbërja 55-65% pambuk dhe 35-45% poliestër paraqet një balancë më të mirë ndërmjet komoditetit dhe performancës teknike të materialit, andaj kërkojmë që pretendimi ynë ankimor të merret parasysh nga ana e AK-së. Në të njëjtën kohë, ne kërkojmë që specifikimet teknike për produktin e lartpërmendur të përmbushen me kërkesat minimale për Wrinkle Recovery sipas standardit të testimit ISO 2313 me kërkesat e mëposhtme: pjerrësia e skajit – min. 100°/weft – min. 100°. Gjithashtu, konsiderojmë se duhet të përcaktohet edhe pesha e materialit të këmishës, pasi kjo është një karakteristikë thelbësore që ndikon në cilësinë, komoditetin dhe qëndrueshmërinë e produktit. Për këtë qëllim, rekomandojmë një peshë prej

110– 130 g/m², e cila konsiderohet e përshtatshme për përdorim të përditshëm dhe afatgjatë. AK-ja në dosje të tenderit e ka shënuar: Afati i liferimit të jetë 60 ditë. Ne si kompani e interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit, sqarojmë se bazuar në përvojën industriale dhe afatet reale të prodhimit të materialeve tekstile institucionale, konsiderojmë se ky afat nuk është i realizueshëm. Vetëm procesi i zhvillimit dhe prodhimit të materialeve tekstile zakonisht kërkon minimum: 60 ditë. Pas kësaj vijnë: • Ngjyrosja e materialeve; • Trajtimet teknike; • Testimet laboratorike; • Procesi i qepjes; • Kontrolli i cilësisë; • Paketimi; • Transporti ndërkombëtar. Duke marrë parasysh se këto veshje nuk prodhohen nga stoku por zhvillohen dhe prodhohen posaçërisht për Policinë e Kosovës, rekomandojmë që afati minimal i dorëzimit të jetë: 160 ditë. Ky afat do të sigurojë prodhim cilësor, testim adekuat dhe furnizim të suksesshëm sipas standardeve të kërkuara. Për të vërtetuar faktin të cilin e sqaruar më lartë ne po e prezantojmë edhe konfirmimin nga një prodhues i cili merret ekskluzivisht me prodhimin e rrobave elegante.

From: Mert UÇAR <MUCAR@yunsa.com>

Date: Fri, May 15, 2026 at 1:14 PM

Subject: RE: Request for Technical Written Confirmation Regarding Suit Fabric Composition and Fabric Development Lead Time

Thank you for your inquiry.

Based on our experience as a fabric manufacturer and developer for tailoring and institutional uniform fabrics, we can confirm the following from a technical and industrial production perspective:

For elegant and formal suits, wool/polyester/elastane compositions are generally more commonly used and technically preferred over wool/polyamide/elastane blends for institutional and uniform applications. Polyester wrinkle resistance, color consistency, and long-term appearance performance, while also offering better suitability for repeated professional use and maintenance.

Polyamide is typically more common in technical or abrasion-oriented textiles, while polyester is more widely used in formal suiting fabrics due to its balance of durability, aesthetic stability, and industrial finish.

Regarding lead times, a requirement of 60 days from Purchase Order for newly developed or customized fabrics is considered extremely challenging under normal industrial manufacturing conditions, especially dyeing, finishing, testing, and production scheduling are involved.

Depending on fabric specifications, quantities, testing requirements, and production planning, customized institutional fabric developments generally require approximately 120–150 days minimum for proper industrial production.

We trust this technical clarification is helpful.

Mert UÇAR

Lider / Leader

Satış ve Müşteri Hizmetleri / Sales & Customer Services



Yünsa Yünlü Sanayi ve Ticaret A.Ş.

Organize Sanayi Bölgesi Çerkezköy - Tekirdağ

T: +90 (282) 726 80 01-02-03-04-05

F: +90 (282) 726 63 85

E: mucar@yunsa.com

www.yunsa.com

kërkojmë që në të gjitha rastet ku specifikohen standarde të caktuara laboratorike ose teknike, të pranohen edhe standarde ekuivalente ndërkombëtare. Për shembull: ISO, EN, DIN, ASTM, AATCC ose standarde të tjera të njohura ndërkombëtarisht që provojnë të

njëtin nivel performance. Kjo kërkesë e jona është në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.? Tek specifikat teknike është kërkuar që OE duhet të ofrojë masa të sakta duke bërë marrjen e masës për secilin zyrtar policor i cili furnizohet me rroba civile, rreth 2,800 zyrtarëve. Rekomandojmë që matjet e detajuara të realizohen për rreth 180 zyrtarë që përfaqësojnë tipe të ndryshme trupore. Bazuar në këto matje mund të zhvillohet një sistem standard madhësish dhe “drop sizes”, sipas praktikave ndërkombëtare të industrisë së veshjeve profesionale dhe njëkohësisht do të ulëj kostoja, pra OE do të ofertojnë me çmim më të lirë.? Gjithashtu ne si kompani rekomandojmë që pas shpalljes së fituesit të lejohet një fazë PPS (Pre-Production Sample) para fillimit të prodhimit masiv.Kjo procedurë mundëson: Verifikimin e materialeve; Verifikimin e ngjyrave; Verifikimin e konstruksionit; Verifikimin e madhësive; Eliminimin e gabimeve para prodhimit.Kjo praktikë përdoret gjerësisht në kontratat ndërkombëtare policore dhe ushtarake, prandaj kërkojmë që të merret parasysh kërkesa jonë.-Në lidhje me pretendimet tona ankimore, autoriteti kontraktues me dt.09.06.2026 ka publikuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku e njëjta në këtë vendim në asnjë mënyrë nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, por ka dhënë disa arsye të krejtësisht të paqëndrueshme dhe të pa mbështetura në fakte konkrete.Sa i përket pretendimit tonë ankimor ku e kemi cekur se AK-ja nuk e ka publikuar formularin standard për korrigjim të gabimeve edhe pse ka bërë ndryshime në dosje të tenderit ku i ka aprovuar një pretendim një operatori ekonomik, AK-ja është arsyetuar se nuk ka pasur korrigjim për faktin se afati i dorëzimit të ofertave ka qenë mbi 10 ditë dhe palët e interesuara kanë pasur qasje në kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzim të asaj kompanie. Një konstatim i tillë i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore, sepse një arsyetim i tillë nuk gjen mbështetje në nenin 24 paragrafi 7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Kjo dispozitë përcakton qartë se çdo ndryshim ose përmirësim i Dosjes së Tenderit bëhet vetëm përmes publikimit të Njoftimit për Informata Shtesë ose Përmirësim të Gabimeve (formulari B54), pa paraparë ndonjë përjashtim për rastet kur kanë mbetur më shumë se 10 ditë deri në afatin e dorëzimit të ofertave.Në rastin konkret, lejimi i materialit poliester krahas materialit poliamid të paraparë në Dosjen e Tenderit përbën ndryshim të specifikimeve teknike, ndërsa qasja e operatorëve ekonomikë në kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së nuk mund të konsiderohet njoftim zyrtar dhe as të zëvendësojë publikimin e formularit B54. Mosformalizimi i këtij ndryshimi ka krijuar trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe ka cenuar parimin e transparencës, pasi që në momentin që në vendim thuhet që refuzohet kërkesa për rishqyrtim, atëherë OE mund edhe të mos e analizojnë vendimin fare sepse refuzimi nënkupton mos aprovim i asnjërit nga pretendimet ankimor.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket tolerancave të lejuara, AK-ja është arsyetuar

se specifikat teknike të hartuara nga AK, nuk i janë përshtatur asnjë prodhuesi dhe specifikat kanë toleranca të mjaftueshme, prandaj kërkesa jonë për ndryshimin e tolerancës prej $\pm 3\%$, në $\pm 5\%$ për të gjithë artikujt dhe jo vetëm për artikuj të caktuar refuzohet. Ndërsa në lidhje me pretendimin ankimor ku ne kemi kërkuar që të bëhen ndryshimet në specifika teknike dhe parametra, AK-ja e ka shënuar se refuzohet kërkesa nga komisioni për hartim të specifikave teknike, sepse specifikat janë hartuar për të ju përshtatur punës nga zyrtaret që janë dedikuar. Sa i përket përgjigjes së AK-së në lidhje me pretendimet tona ankimore për tolerancat dhe parametrat teknikë, konsiderojmë se AK-ja nuk ka trajtuar në mënyrë konkrete dhe të argumentuar pretendimet tona, por ka devijuar nga thelbi i tyre duke dhënë përgjigje të përgjithshme. Konkretisht, ne kemi kërkuar që AK-ja të arsyetojë pse për artikujt Rrobat Elegante [Kat] për Zyrtarët Policor dhe Setra për Zyrtarët/Hetuesit Policor është përcaktuar toleranca $\pm 3\%$, ndërsa për artikujt e tjerë, përfshirë pantallonat, është lejuar toleranca $\pm 5\%$. Gjithashtu, kemi kërkuar sqarim të mënyrës së llogaritjes së këtyre tolerancave, pasi specifikimi aktual nuk e bën të qartë nëse toleranca llogaritet për secilin komponent të materialit apo në ndonjë mënyrë tjetër, gjë e cila mund të çojë në interpretime të ndryshme dhe në vlerësim jo të njëjtë të mostrave. Megjithatë, AK-ja nuk ka dhënë asnjë sqarim për këto çështje, por është mjaftuar me deklarin e përgjithshëm se specifikat nuk i janë përshtatur ndonjë prodhuesi dhe se tolerancat janë të mjaftueshme. Një përgjigje e tillë nuk i përgjigjet fare pretendimit tonë, pasi ne nuk kemi pretenduar se specifikat janë hartuar për një prodhues të caktuar, por kemi kërkuar bazën teknike dhe profesionale mbi të cilën janë përcaktuar toleranca të ndryshme për artikuj të ndryshëm. Me këtë veprim AK-ja ka bërë shkelje të nenin 108/A të LPP-së, sepse nuk i është përgjigjur në mënyrë konkrete pretendimeve tona ankimore, por është mjaftuar me arsyetime të përgjithshme të cilat nuk argumentojnë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore. Po ashtu, lidhur me parametrat teknikë të specifikuar në dosje të tenderit, ne kemi paraqitur argumente konkrete dhe rekomandime teknike, duke kërkuar që përbërja e materialit të pantallonave dhe setrës të jetë e njëjtë dhe dallimi ndërmjet tyre të bëhet vetëm përmes peshës së materialit. Ky pretendim është paraqitur edhe duke pasur parasysh se vetë AK-ja, në përgjigjen e dhënë ndaj një operatori tjetër ekonomik, ka arsyetuar se pantallonat dhe setra kombinohen mes vete dhe duhet të përshtaten për nevoja policore. Megjithatë, pavarësisht këtij arsytimi, AK-ja ka përcaktuar për pantallonat përbërjen 86% lesh, 10% poliamid dhe 4% elastan me tolerancë $\pm 5\%$, ndërsa për setrën përbërjen 70% lesh, 26% poliamid dhe 4% elastan me tolerancë $\pm 3\%$, pa dhënë asnjë arsyetim teknik apo profesional se përse dy artikuj që sipas vetë AK-së kombinohen mes vete dhe janë pjesë e të njëjtit komplet duhet të kenë përbërje të ndryshme të materialit dhe toleranca të ndryshme. Në vend se të trajtonte këtë kundërtënie dhe të paraqiste ndonjë analizë apo bazë profesionale që justifikon këto dallime, AK-ja është mjaftuar me deklarin e përgjithshëm se specifikat janë hartuar për tui përshtatur punës së zyrtarëve policorë. Për më tepër, ne kemi paraqitur rekomandime konkrete lidhur me përbërjen e materialeve, peshën e tyre, si dhe karakteristikat e tjera teknike, duke argumentuar se këto rekomandime synojnë sigurimin e komoditetit më të lartë gjatë përdorimit të përditshëm, qëndrueshmërisë më të mirë dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Megjithatë, AK-ja nuk ka trajtuar asnjërin nga këto argumente dhe nuk ka paraqitur ndonjë analizë, studim, raport profesional apo ndonjë bazë objektive mbi të cilën janë përcaktuar parametrat aktualë. Përkundrazi, përgjigjja e saj është kufizuar në konstatime të përgjithshme, pa kundërshtuar në mënyrë konkrete argumentet e paraqitura nga ne.

Andaj si përfundim, konsiderojmë se AK-ja nuk ka arritur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore me prova, analiza apo arsyetime profesionale, por ka devijuar nga thelbi i tyre duke dhënë përgjigje të përgjithshme, pa adresuar çështjet

konkrete të ngritura nga ne. Mosdhënia e një arsyetimi teknik për dallimin e tolerancave, mungesa e sqarimit për mënyrën e llogaritjes së tyre, si dhe mospërputhja ndërmjet vetë arsytimit të AK-së se pantallonat dhe setra kombinohen mes vete dhe specifikimeve të ndryshme të përcaktuara për këto artikuj, tregojnë se refuzimi i pretendimeve tona nuk është mbështetur në analiza objektive dhe profesionale, por vetëm në konstatime të përgjithshme, të cilat nuk mund të konsiderohen si trajtim i plotë dhe i arsyetuar i kërkesës sonë për rishqyrtim.-Sa i përket pretendimit tone ne lidhje me afatin e liferimit prej 60 ditësh, konsiderojmë se AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsyetim teknik apo profesional mbi bazën e të cilit ka konstatuar se ky afat është i mjaftueshëm. Në pretendimin tonë ankimor kemi sqaruar se veshjet e kërkuara nuk prodhohen nga stoku, por zhvillohen dhe prodhohen posaçërisht sipas kërkesave të Policisë së Kosovës, proces i cili përfshin zhvillimin dhe prodhimin e materialit, ngjyrosjen, trajtimet teknike, testimet laboratorike, procesin e qepjes, kontrollin e cilësisë, paketimin dhe transportin ndërkombëtar. Për më tepër, kemi paraqitur edhe konfirmim me shkrim nga prodhuesi YUNSA, një prodhues i specializuar i materialeve për veshje institucionale, i cili ka sqaruar se vetëm zhvillimi dhe prodhimi i materialeve të personalizuar kërkon së paku 120 deri në 150 ditë në kushte normale industriale dhe se një afat prej 60 ditësh konsiderohet jashtëzakonisht sfidues për realizim.Edhe pse ne e kemi dëshmuar me fakte konkrete pretendimin tonë ankimor, AK-ja nuk ka trajtuar argumentet dhe provat e paraqitura nga ne, përfshirë edhe konfirmimin e prodhuesit, por është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se afati i liferimit është i mjaftueshëm, pa paraqitur ndonjë analizë, mendim profesional apo bazë teknike që do të kundërshtonte pretendimet tona. Për rrjedhojë, refuzimi i këtij pretendimi është bërë pa një vlerësim objektiv dhe të argumentuar, duke lënë pa adresuar faktin se afati prej 60 ditësh mund të kufizojë konkurrencën dhe të favorizojë operatorët ekonomikë që posedojnë stok të gatshëm ose qasje të menjëhershme në materiale të prodhuara paraprakisht.-Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për pranimin e standardeve ekuivalente ndërkombëtare, AK-ja ka devijuar nga vetë pretendimi ynë duke u arsyetuar se standardet e kërkuara janë të nevojshme për të garantuar cilësinë dhe se nuk favorizojnë asnjë prodhues. Ne nuk kemi kontestuar nevojën për testime dhe as rëndësinë e standardeve të kërkuara, por kemi kërkuar që krahas standardeve të specifikuara të pranohen edhe standarde të tjera ekuivalente ndërkombëtare, të cilat dëshmojnë të njëjtin nivel të performancës dhe cilësisë. Për rrjedhojë, arsyetimi i AK-së nuk trajton thelbin e pretendimit tonë dhe nuk jep asnjë shpjegim se përse standardet ekuivalente, si ISO, EN, DIN, ASTM, AATCC apo standarde të tjera të njohura ndërkombëtarisht, nuk mund të pranohen.Për më tepër, AK-ja nuk ka paraqitur asnjë analizë apo argument teknik që do të vërtetonte se vetëm standardet e kërkuara në dosje nuk mund të dëshmojnë parametrat e kërkuar, ndërsa standardet e tjera ekuivalente nuk do të garantonin të njëjtin nivel të cilësisë.-Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për mënyrën e matjes së zyrtarëve policorë, AK-ja është mjaftuar vetëm

me konstatimin se kërkesa mbetet e pandryshuar dhe se operatorët ekonomikë duhet ti përmbahen dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Një përgjigje e tillë nuk përbën trajtim të pretendimit tonë, pasi ne kemi paraqitur një rekomandim të bazuar në praktikat ndërkombëtare të industrisë së veshjeve profesionale, duke propozuar që matjet e detajuara të realizohen për një numër përfaqësues të zyrtarëve dhe mbi këtë bazë të zhvillohet sistemi i madhësive dhe “drop sizes”. Kjo qasje do të mundësonte uljen e kostove dhe rrjedhimisht oferta më ekonomike për Autoritetin Kontraktues. Megjithatë, AK-ja nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike, ekonomike apo profesionale me të cilën do.

Kundërshtonte këtë pretendim, por është kufizuar në një deklaram të përgjithshëm, pa dhënë arsyetim se përse matja individuale e rreth 2,800 zyrtarëve konsiderohet zgjidhja më e përshtatshme dhe më ekonomike.-Po ashtu lidhur me rekomandimin tonë për lejimin e fazës PPS (Pre-Production Sample), AK-ja nuk ka dhënë asnjë qëndrim konkret, ndonëse kjo praktikë përdoret gjerësisht në kontratat ndërkombëtare të furnizimeve policore dhe ushtarake dhe shërben për eliminimin e gabimeve para fillimit të prodhimit masiv.Si përfundim arsyetimi i autoritetit kontraktues në lidhje me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore konkrete, për më tepër është një vendim diskriminues, pasi që me arsyetime të tilla po ju pamundësohet ofertimi kompanive të interesuara për këtë aktivitet të prokurimit.Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”.Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon

konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”.Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuar.

kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIMAPROVOHET, si e bazuar ankesa e OE “Smart X Industries” SH.P.K. DETYROHET AK të bëj ndryshimin e kërkesave, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetentE.

Specifikat teknike

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Smart X Industries SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimin nr 1

OE ankues „Smart X Industries SH.P.K” pretendon se Autoriteti Kontraktues, Policia e Kosovës nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së.

Ekspertja thekson se ndër tjera qellim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen,si dhe të siguroj integritetin dhe pergjegjësinë e zyrtarëve publik.

AK e ka trajtuar kërkesën për rishyrtim të OE ankues si të pa bazuar, me arsyen se kriteret dhe specifikat e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nuk janë në kundërshtim me dispozitat e përmendura nga OE ankues .

OE pretendon se Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar specifikimet teknike gjatë procedurës (lejimi i materialit alternativ) pa ndryshuar zyrtarisht Dosjen e Tenderit dhe pa publikuar shtojcën përkatëse.

Është lejuar material alternativ vetëm përmes përgjigjeve në platformë, pa ndryshim formal të dokumentacionit, megjithatë AK ka dhënë një përgjigjeje që është ngarkuar në platformën elektronike të e- prokurimit dhe është e qasëshme për të gjithë operatorët ekonomik, sepse edhe vetë ju po e potenconi se e keni lexuar përgjigjejen se AK e cila ka lejuar që të ofrohet edhe me material Polyester. Ekspertja është e mendimit se nuk qëndron pretendimi i OE ankues .

Andaj ,Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

OE ankues „Smart X Industries SH.P.K” pretendon se Autoriteti Kontraktues, Policia e Kosovës nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së.

Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i nenit 7 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Pretendimi i OE ankues: se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së

Ekspertja sqaron se, sa i përket pretendimit të OE ankues, është i pa bazuar sepse gjatë ekzaminimit të landës dhe kërkesave të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit nuk janë vërejtur se ka pasur diskriminim apo favorizim të ndonjë operatori ekonomik.

Andaj,Ekspertja sqaron se pretendimi është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3.

OE ankues „Smart X Industries SH.P.K” pretendon se Autoriteti Kontraktues, Policia e Kosovës ka rënë nënshkrimin me nenin 27 të LPP-së dhe neni 17.7 Rregullores nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik (Versioni i Konsoliduar).

Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të përpilojnë dosjen e tenderit që ofron informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i shihet të domosdoshme autoriteti kontraktues.

Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të përmbajë një kopje të njoftimit të tillë dhe informatat e tjera të tilla përkatëse që mund të jenë të nevojshme për të qartësuar dhe plotësuar informatat që gjenden në njoftimin e tillë. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të

zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nënkontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

Ndërsa ndër të tjera qellimi i nen 17.7 është citoj:

Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga: - Formulari i tenderit - Lista e çmimeve.

Nga shqyrtimi i dosjes së tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar për secilin artikull përbërjen e materialeve, parametrat teknikë, tolerancat dhe kërkesat për testime laboratorike. Dosja përmban specifikime të detajuara dhe kërkon që ofertat të jenë në përputhje me to.

Nga ankesa rezulton se OE kundërshton:

- përbërjen e disa materialeve;
- tolerancat e përcaktuara;
- kërkesat për certifikime dhe testime laboratorike;
- disa parametra teknikë që, sipas tij, mund të kufizojnë konkurrencën

Nga ana tjetër, në vendimin për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se:

- specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni profesional sipas nevojave funksionale të Policisë së Kosovës;
- kërkesat teknike nuk janë hartuar për të favorizuar ndonjë operator ekonomik;
- tolerancat dhe testimet janë përcaktuar për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e mallrave.

Pas analizës së dokumentacionit në dispozicion, **nuk rezulton se vetëm ekzistenca e specifikimeve të detajuara përbën, në vetvete, shkelje të nenit 27 të LPP-së ose nenit 17.7 të Rregullores.** Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë karakteristikat teknike të mallrave që synon të blejë, për sa kohë ato lidhen me nevojat funksionale dhe nuk kufizojnë konkurrencën në mënyrë të pajustifikuar.

Pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik, dosjes së tenderit dhe vendimit të Autoritetit Kontraktues, konstatohet se pjesa më e madhe e pretendimeve të ankuesit përbëhet nga **rekomandime teknike** lidhur me përbërjen e materialeve, tolerancat, standardet laboratorike, mënyrën e marrjes së masave, fazën PPS (Pre-Production Sample), afatin e liferimit dhe parametrat teknikë të artikujve.

Sipas **nenit 27 të Ligjit për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nevojat funksionale të institucionit, duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Po ashtu, **neni 17.7 i Rregullores nr. 001/2022**, i ndryshuar me Rregulloren nr. 002/2024, ndalon hartimin e dokumenteve të tenderit në mënyrë që kufizon pa arsye konkurrencën ose favorizon operatorë ekonomikë të caktuar.

Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka hartuar specifikimet teknike duke iu referuar një prodhuesi, marke ose operatori ekonomik të caktuar. Përkundrazi, në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se

specifikimet janë hartuar nga komisioni profesional mbi bazën e nevojave operative të Policisë së Kosovës.

Sa i përket pretendimit se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetime të mjaftueshme teknike për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, eksperti vlerëson se arsyetimi i vendimit është në disa pjesë i përgjithshëm dhe nuk adreson në mënyrë të veçantë çdo argument teknik të paraqitur nga ankuesi, siç janë mënyra e llogaritjes së tolerancave, arsyetimi për dallimin ndërmjet tolerancës $\pm 3\%$ dhe $\pm 5\%$, apo analiza lidhur me rekomandimet teknike të operatorit ekonomik. Megjithatë, **mungesa e një arsyetimi më të detajuar nuk nënkupton automatikisht se specifikimet teknike janë të kundërligjshme**, nëse ato mbështeten në nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktues. Andaj

Lidhur me pretendimin për pranimin e standardeve ekuivalente ndërkombëtare (ISO, EN, DIN, ASTM, AATCC etj.), eksperti vlerëson se, sipas parimeve të prokurimit publik, kur specifikimet teknike bazohen në standarde të caktuara, Autoriteti Kontraktues duhet të lejojë edhe prova ose standarde ekuivalente, nëse ato garantojnë të njëjtin nivel të performancës. Nëse dokumentacioni i tenderit përjashton pa arsyetim pranimin e standardeve ekuivalente, kjo duhet të shqyrtohet nga paneli në raport me parimin e konkurrencës dhe proporcionalitetit. Mirpo OE ankues ne ne kete rast nuk ka arritur qe me prova dhe se edhe lejimi nga ana e AK me standarte ekujvalente kan te njejtin nivel te performances. Andaj edhe pretendimi ankimor eshte i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit për afatin e liferimit prej 60 ditësh, ankuesi ka paraqitur një deklaratë të prodhuesit për kohën e prodhimit. Megjithatë, nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton se është paraqitur një analizë e tregut që dëshmon se afati prej 60 ditësh është objektivisht i parealizueshëm për shumicën e operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, vetëm paraqitja e një deklarate nga një prodhues nuk është e mjaftueshme për të provuar se kërkesa e Autoritetit Kontraktues kufizon konkurrencën.

Po ashtu, rekomandimet për ndryshimin e mënyrës së marrjes së masave, zhvillimin e sistemit të madhësive ("drop sizes") dhe aplikimin e fazës PPS para prodhimit masiv përfaqësojnë alternativa teknike dhe praktika të industrisë, por **Ligji për Prokurimin Publik nuk e detyron Autoritetin Kontraktues të pranojë çdo rekomandim teknik të operatorëve ekonomikë**, përderisa specifikimet e hartuara janë objektivisht të lidhura me nevojat e kontratës dhe nuk provohet se janë diskriminuese.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, eksperti vlerëson se:

- **pretendimet që lidhen me rekomandimet teknike** për ndryshimin e përbërjes së materialeve, peshës, mënyrës së matjes, fazës PPS dhe afatit të liferimit **nuk rezultojnë të bazuara**, pasi ato përfaqësojnë alternativa teknike dhe jo shkelje të provuara të Ligjit për Prokurimin Publik;
- **pretendimi që Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim të detajuar për disa çështje teknike është pjesërisht i bazuar**, në kuptimin që vendimi mund të ishte më i plotë në trajtimin e argumenteve të ankuesit, por kjo, në vetvete, nuk provon paligjshmërinë e specifikimeve teknike;
- **pretendimi për pranimin e standardeve ekuivalente ndërkombëtare**-Mirpo OE ankues ne ne kete rast nuk ka arritur qe me prova dhe se edhe lejimi nga ana e AK me standarte ekujvalente kan te njejtin nivel te performances. Andaj edhe pretendimi ankimor eshte i pa bazuar;

në tërësi, nga provat e administruara nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka hartuar dokumentacionin e tenderit në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, nenin 7 të LPP-së ose nenin 17.7 të Rregullores nr. 001/2022, në atë masë që do të justifikonte anulimin ose ndryshimin e procedurës vetëm mbi bazën e pretendimeve të paraqitura

Autoriteti kontraktues në pajtim me te dy nenet ka vepruar sepse ka hartuar dosjen me specifika të cilat i nevojiten autoritetit kontraktues pa bërë favorizime dhe diskriminime.

Andaj ,Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimin nr. 4.

Operatori Ekonomik "Smart X Industries SH.P.K." pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos pranuar propozimet e tij për ndryshimin e specifikimeve teknike, tolerancave, përbërjes së materialeve dhe afatit të liferimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, ankesës dhe vendimit të Autoritetit Kontraktues, konstatohet se **pretendimet e OE nuk lidhen me procesin e shqyrtimit, vlerësimit ose krahasimit të ofertave**, por kanë të bëjnë me përmbajtjen e specifikimeve teknike dhe kushteve të tenderit, të cilat janë hartuar para afatit për dorëzimin e ofertave.

Neni 69 i LPP-së rregullon procedurën që Autoriteti Kontraktues duhet të ndjekë gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të dorëzuara, duke verifikuar përputhshmërinë e tyre me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Ky nen nuk e detyron Autoritetin Kontraktues të ndryshojë specifikimet teknike dhe kriteret e parapara në njoftim për kontrat dhe dosjen e tenderit, ku të gjitha kriteret janë në harmoni me legjislacionin e prokurimit publik , apo të pranojë rekomandimet teknike të operatorëve ekonomikë gjatë fazës së pyetjeve dhe kërkesave për rishqyrtim.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere në njoftim për kontrat dhe dosjen e tenderit në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së.

Pretendimi ankimor për shkelje të nenit 69 të LPP-së është i pabazuar,

Përgjigje në Pretendimin nr. 5.

Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 24 dhe 25 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Operatori Ekonomik "Smart X Industries SH.P.K." pretendon se Autoriteti Kontraktues, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, ka dhënë sqarime dhe përgjigje lidhur me specifikimet teknike, tolerancat, katalogun e ngjyrave, përbërjen e materialeve dhe afatin e dorëzimit, të cilat sipas tij duhej të pasqyroheshin përmes ndryshimit formal të Dosjes së Tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ rezulton se Autoriteti Kontraktues ka trajtuar kërkesat për sqarim dhe kërkesën për rishqyrtim, duke arsyetuar se specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni profesional sipas nevojave funksionale të Policisë së Kosovës dhe se nuk ka parë të nevojshme ndryshimin e tyre.

Neni 24 i Rregullores nr. 001/2022 rregullon procedurën e dhënies së informacioneve shpesh dhe ndryshimit të dokumenteve të tenderit. Kur përgjigjet ose sqarimet e Autoritetit

Kontraktues ndryshojnë ose plotësojnë në mënyrë materiale përmbajtjen e dokumenteve të tenderit, ato duhet të pasqyrohen përmes një ndryshimi formal të dokumentacionit dhe, kur është e nevojshme, të shoqërohen me zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton se përgjigjja lidhur me **katalogun me kodet e ngjyrave** ka krijuar një kërkesë të re, pasi kjo kërkesë ishte e përfshirë edhe në specifikimet teknike të dosjes së tenderit. Për rrjedhojë, në këtë pjesë nuk konstatohet ndryshim material që Andaj ,Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Sa i përket **nenit 25 të Rregullores**, i cili lidhet me përmbajtjen dhe administrimin e dokumenteve të tenderit dhe sigurimin që operatorët ekonomikë të kenë qasje të barabartë në informacionin relevant, nga dokumentacioni nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomikë ose se ka mbajtur informacion të fshehur nga pjesëmarrësit. Përgjigjet dhe vendimi janë bërë pjesë e dokumentacionit të procedurës dhe kanë qenë të disponueshme për operatorët ekonomikë përmes sistemit elektronik të e-prokurimit.

Ekspertja konstaton se pas analizës së dokumentacionit të administruar, **nuk konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 dhe nenin 25 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, pasi:

nuk është provuar se janë bërë ndryshime materiale në dokumentet e tenderit që do të kërkonin publikimin e një ndryshimi formal;

përgjigjja lidhur me katalogun e kodeve të ngjyrave vetëm ka sqaruar një kërkesë që tashmë ekzistonte në dosjen e tenderit;

mospranimi i propozimeve të operatorit ekonomik për ndryshimin e specifikimeve teknike nuk përbën, në vetvete, shkelje të nenit 24 ose 25 të Rregullores.

Pretendimi ankimor i OE "Smart X Industries SH.P.K." për shkelje të nenit 24 dhe 25 të Rregullores nr. 001/2022 **konsiderohet si i pabazuar** bazuar

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Smart X Industries SH.P.K.**

Teuta Krasniqi

